



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2018 – Numri: 197

Tiranë – E martë, 15 janar 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 106/2018 datë 20.12.2018	Për disa ndryshime në ligjin nr. 9573, datë 3.7.2006, “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”, të ndryshuar..... 15283
Ligj nr. 107/2018 datë 20.12.2018	Për një shtesë në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 15283
Ligj nr. 108/2018 datë 20.12.2018	Për një shtesë në ligjin nr. 8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve”, të ndryshuar..... 15284
Ligj nr. 109/2018 datë 20.12.2018	Për statusin e dëshmorit të atdheut..... 15285
Ligj nr. 112/2018 datë 20.12.2018	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 108/2014, “Për policinë e shtetit”, të ndryshuar..... 15292
Ligj nr. 113/2018 datë 20.12.2018	Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust-it..... 15294



LIGJ
Nr. 106/2018

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN
NR. 9573, DATË 3.7.2006, “PËR
AUTORIPARIMIN, SHITBLERJEN,
DEPOZITIMIN E MJETEVE RRUGORE
ME MOTOR, TË RIMORKIOVE DHE
PJESËVE TË TYRE TË DALA JASHTË
PËRDORIMIT OSE TË BRAKTISURA
DHE PËR VEPRIMTARITË QË LIDHEN
ME TO”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9573, datë 3.7.2006, “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 2/1 hiqet numri 18.

Neni 2

Neni 21 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 21

Ushtrimi i veprimtarisë së një agjencie

1. Veprimtaritë e parashikuara në nenin 20, të këtij ligji, kryhen nga subjektet në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

2. Kriteret për ushtrimin e kësaj veprimtarie dhe numri i agjencie, për çdo qytet, përcaktohen me udhëzim të ministrit që mbulon fushën e transportit, duke pasur parasysh numrin e mjeteve me motor të regjistruara.”.

Neni 3

Neni 22 ndryshohet si më poshtë

“Neni 22
Njoftimi i agjencie

1. Subjektet, titullari i të cilave ka aftësitë profesionale, sipas neneve 23 e 29, të këtij ligji, ushtrojnë veprimtarinë e trajtimit të praktikave të qarkullimit të mjeteve me motor.

2. Subjektet duhet të kenë të regjistruar në regjistrin tregtar si objekt të veprimtarisë së tyre trajtimin e praktikave të qarkullimit të mjeteve me motor.”.

Neni 4

Në nenin 29, pikat 1 e 4 ndryshohen si më poshtë:

“1. Ushtrimi i veprimtarisë së shitblerjes, të ndërmjetësimit, të autoriparimit për mjetet rrugore me motor dhe rimorkiot, të autorizuar nga prodhuesi i tyre, kryhet nga subjektet juridike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, të cilat kanë të regjistruar në regjistrin tregtar, si objekt të veprimtarisë së tyre, ushtrimin e këtyre veprimtarive.

4. Tarifat e dhënies së autorizimeve të përcaktuara në pikat 2 e 3, të këtij neni, miratohen nga ministri përgjegjës për financat.”.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 20.12.2018

Shpallur me dekretin nr.11048, datë 14.1.2019
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Ilir Meta

LIGJ
Nr. 107/2018

PËR NJË SHITESË NË LIGJIN
NR. 9918, DATË 19.5.2008, “PËR
KOMUNIKIMET ELEKTRONIKE
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,



KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhet kjo shtesë:

Neni 1

Në nenin 55, pika 2, pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:

“c) shërbimet e *roaming-ut* mbi bazën e marrëveshjeve ndërkombëtare dy ose shumëpalëshe, të nënshkruara apo të miratuara për zbatim reciprok të rregullimit të tarifave për këto shërbime, si dhe tarifave të terminimit ndërkombëtar të lidhura me këto shërbime.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 20.12.2018

Shpallur me dekretin nr.11049, datë 14.1.2019 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

LIGJ
Nr. 108/2018

PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 8328, DATË 16.4.1998, “PËR TË DREJTAT DHE TRAJTIMIN E TË DËNUARVE ME BURGIM DHE TË TË PARABURGOSURVE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pikat 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr. 8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve”, të ndryshuar, pas nenit 13 shtohet neni 13/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 13/1

Regjimi i posaçëm në burgun e sigurisë së lartë

1. Në raste të veçanta, sipas përcaktimeve të këtij neni, një regjim i posaçëm i ushtrimit të të drejtave mund zbatohet për të dënuarit në burgun e sigurisë së lartë dhe të paraburgosurit që hetohen apo gjykohen për këto vepra penale, të parashikuara në nenet 79, shkronja “ç”, 79/a, 79/b, 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 231, 232, 232/a, 234, 234/a, 234/b, 283, paragrafi 3, 283/a, paragrafi 3, 284, paragrafi 3, 284/a, 284/c, paragrafi 3, 284/ç, paragrafi 3, 333, 333/a dhe 334 të Kodit Penal, të kryera në kuadër të pjesëmarrjes në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë të armatosur, organizatë terroriste ose për vepra me qëllime terroriste.

2. Vendimi për vendosjen e të dënuarit ose të paraburgosurit në regjimin e posaçëm në burgun e sigurisë së lartë merret nga ministri i Drejtësisë mbi kërkesën e arsyetuar të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, pas konsultimit me ministrin e Brendshëm, bazuar në të dhënat/informacionet e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Shërbimit Informativ Shtetëror, Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve dhe organeve të specializuara në luftën kundër krimit të organizuar e terrorizmit, sipas fushave të përgjegjësisë.

3. Vendosja e regjimit të posaçëm të ushtrimit të të drejtave në burgun e sigurisë së lartë bazohet vetëm në ruajtjen e rendit dhe të sigurisë dhe/ose parandalimin e komunikimit me organizatën kriminale ku bëjnë pjesë apo me organizata të tjera, të referuara në pikën 1, të këtij neni, nëpërmjet marrjes së masave të brendshme dhe të jashtme të sigurisë së lartë, që lidhen, kryesisht, me nevojën për të parandaluar:

a) kontaktet me organizatën kriminale ku bëjnë pjesë apo me organizata të tjera, me të cilat ata bashkëpunojnë;

b) konfliktet e mundshme me elementë të organizatave të tjera;

c) ndërveprimin me të burgosurit apo të paraburgosurit e tjerë, të cilët i përkasin së njëjtës organizatë ose të organizatave të tjera, me të cilat ata bashkëpunojnë;

ç) komunikimin apo shkëmbimin e sendeve ndërmjet të dënuarve apo të paraburgosurve që i përkasin grupeve të ndryshme.



4. Regjimi i posaçëm i ushtrimit të të drejtave konsiston në:

a) lejimin e një takimi familjar në muaj, i cili kryhet në intervale të rregullta kohore dhe në mjedise të caktuara, ku ndalohej hyrja e personave apo sendeve të tjera dhe që i nënshtrohen regjistrimit audio dhe video. Me termin “familjarë” nënkuptohen të paralindurit, të paslindurit, bashkëshortët dhe bashkëjetuesit. Takimi me persona të ndryshëm nga familjarët, për personat e dënuar, lejohet me propozimin e drejtorit të institucionit dhe me miratimin e ministrit të Drejtësisë. Për personat e paraburgosur, takimi me persona të ndryshëm nga familjarët lejohet vetëm me miratimin e prokurorit. Parashikimet e këtij paragrafi nuk zbatohen për takimet me avokatët mbrojtës;

b) lejimin e të dënuarit ose të paraburgosurit, i cili nuk kryen takime familjare, për kryerjen një bisede telefonike në muaj, me kohëzgjatje maksimale dhjetë minuta, e cila regjistrohet. Kryerja e bisedave telefonike për personat e dënuar autorizohet me vendim të arsyetuar të Drejtorit të Përgjithshëm të Burjeve, kurse, për personat e paraburgosur, ajo autorizohet me vendim të arsyetuar të prokurorit. Parashikimet e këtij paragrafi nuk zbatohen për kryerjen e bisedave telefonike me institucionin e Avokatit të Popullit dhe me organizata vendase ose të huaja, që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut;

c) ndalimin e përdorimit të vlerave monetare, sendeve dhe objekteve që mund të marrë i dënuari ose i paraburgosuri nga jashtë, sipas parashikimeve në rregulloren e brendshme të institucionit;

ç) kontrollin e korrespondencës, përveç asaj me subjektet e përcaktuara në nenin 43, të këtij ligji, ose me organizata ndërkombëtare, që ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut;

d) reduktimin e qëndrimit në ajrim në mjedise të hapura, deri në 2 orë, por jo më pak se 1 orë në ditë;

dh) përjashtimin nga organet përfaqësuese të të dënuarve apo të paraburgosurve.

5. Kohëzgjatja e regjimit të posaçëm të ushtrimit të të drejtave në burgun e sigurisë së lartë është një vit. Me kërkesë të të dënuarit ose të paraburgosurit, pas një periudhe njëvjeçare, ministri i Drejtësisë, në bazë të propozimit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, mund të rivlerësojë nëse janë kushtet për

vazhdimin e regjimit të posaçëm të ushtrimit të të drejtave ndaj të dënuarit ose të paraburgosurit.

6. Kundër vendimit të ministrit të Drejtësisë, për vendosjen apo zgjatjen e regjimit të posaçëm, i dënuari, i paraburgosuri apo avokati mbrojtës mund të paraqesin kërkesë ankimore brenda 20 ditëve, nga momenti i njoftimit të vendimit.

7. Kërkesa ankimore depozitohet në gjykatën e shkallës së parë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, e cila është kompetente për gjykimin e çështjes, sipas parashikimit të nenit 480, të Kodit të Procedurës Penale. Gjykimi i çështjes nuk pezullon vendimin e ministrit të Drejtësisë.

8. Në rastet kur kërkesa kundër vendimit të ministrit të Drejtësisë pranohet nga gjykata, ministri i Drejtësisë vendos bazuar në vendimin e gjykatës.”.

Neni 2

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 20.12.2018

Shpallur me dekretin nr. 11050, datë 14.1.2019 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

LIGJ

Nr. 109/2018

PËR STATUSIN E DËSHMORIT TË ATDHEUT

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i kritereve dhe procedurës për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut”, si dhe të drejtat e përfitimit që rrjedhin nga ky status.



Neni 2 Qëllimi

Qëllimi i ligjit është shpallja ose njohja e statusit “Dëshmor i atdheut” për personat, të cilët me akte të rralla patriotizmi, vetëmohimi dhe heroizmi, kontribuan në luftën për liri, pavarësi dhe çlirim kombëtar të Shqipërisë, deri në dhënien e jetës, si dhe për personat, të cilët kanë dhënë e japin jetën për mbrojtjen e integritetit territorial, të interesave kombëtarë shqiptarë, në luftën kundër terrorizmit dhe krimit ndaj jetës së individit, mbrojtjen e pronës publike, si dhe në raste fatkeqësish natyrore, në ndihmë të popullsisë.

Neni 3 Subjektet

Subjekte të këtij ligji janë dëshmorët e atdheut, familjarët e tyre, organizatat e dëshmorëve të atdheut, organet e pushtetit qendror e të njëjësive të vetëqeverisjes vendore, që ngarkohen për ndjekjen dhe zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ky ligj.

Neni 4 Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Person” është personi fizik me shtetësi shqiptare, shtetasi i huaj ose pa shtetësi që ka jetuar e vepruar përpara datës së krijimit të shtetit shqiptar (28 nëntor 1912).

2. “Shpallje” është vendimi i Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i atdheut”, që i jep të ndjerit statusin e “Dëshmorit të atdheut”.

3. “Njohje” është vendimi i Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i atdheut”, që konfirmon të gjitha dekretet dhe vendimet e dhëna nga organet shtetërore për shpalljen “Dëshmor” përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

4. “Familje e Dëshmorit të atdheut” është familja që i ka dhënë Shqipërisë një apo më shumë persona të shpallur “Dëshmor i atdheut”.

5. “Organe shtetërore të mëparshme” janë ish-organet shtetërore përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, si p.sh.: ish-Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Rrethit, ish-Këshilli Ekzekutiv Pluralist i Rrethit, Këshilli Bashkiak, si dhe Kuvendi Popullor apo Kryesia e Këshillit të Ministrave.

6. “Subjekte kërkuuese” janë përfaqësues të familjes së të rënit, për të cilin kërkohet që të

shpallet ose të njihet “Dëshmor i atdheut”, përfaqësues të familjes së dëshmorit, drejtues të organeve shtetërore, organizatave të dëshmorëve të atdheut, si dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

7. “Organe publike” janë organet përfaqësuese të pushtetit qendror e vendor, institucionet e administratës qendrore dhe vendore, organet kushtetuese, personat juridikë e fizikë, në masën që ata përmbushin funksionet publike ose ushtrojnë një detyrë administrative, sipas ligjeve në fuqi.

KREU II KRITERET PËR SHPALLJEN OSE NJOHJEN E STATUSIT “DËSHMOR I ATDHEUT”

Neni 5

Kriteret për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut”

Dëshmorë të atdheut shpallen ose u njihet statusi, si të tillë:

a) personat, të cilët kanë humbur jetën për lirinë, pavarësinë kombëtare dhe mbrojtjen e territoreve shqiptare apo në përpjekje për mësimin dhe përhapjen e gjuhës shqipe para datës 28 nëntor 1912;

b) shtetasit shqiptarë e të huaj, të cilët kanë rënë në luftë për mbrojtjen e integritetit territorial, të lirisë e pavarësisë së Shqipërisë, si dhe për arsye të kundërshtimit të pushtimit të trojeve shqiptare nga ushtritë e huaja dhe të qëllimeve shoviniste të tyre, nga data 28 nëntor 1912 deri më 7 prill 1939;

c) shtetasit shqiptarë, të cilët kanë humbur jetën në mbrojtje të vlerave kombëtare e patriotike të kombit shqiptar para datës 7 prill 1939;

ç) shtetasit shqiptarë, të cilët kanë marrë pjesë me armë në dorë ose në formë të organizuar në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe kanë rënë duke luftuar kundër pushtuesve nazifashistë e bashkëpunëtorëve të tyre, nga data 7 prill 1939 deri më 9 maj 1945;

d) shtetasit shqiptarë të pushkatuar për pjesëmarrjen në formacionet luftarake të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare apo për mbështetje të pjesëmarrësve të Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar, si dhe të pushkatuar për hakmarrje nga pushtuesit nazifashistë apo bashkëpunëtorët e tyre, nga data 7 prill 1939 deri më 9 maj 1945;



dh) shtetasit shqiptarë, të cilët janë ekzekutuar apo kanë vdekur në burgjet dhe kampet nazifashiste të përqendrimit apo kanë vdekur si pasojë e plagëve apo sëmundjeve të ndryshme të marra në këto vende deri më 9 maj 1945;

e) shtetasit shqiptarë, pjesëtarë të formacioneve ushtarake të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, të cilët kanë rënë në luftën kundër pushtuesve nazifashistë jashtë kufijve shtetërorë deri më 9 maj 1945;

ë) shtetasit shqiptarë, pjesëmarrës në formacione të rregullta të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, të cilët kanë humbur jetën brenda datës 9 maj 1947 për shkak të sëmundjeve dhe plagëve të marra ose fatkeqësive të ndryshme, duke qenë në krye të detyrës luftarake;

f) shtetasit shqiptarë që kanë rënë duke luftuar në Spanjë (1936-1939) ose në vende të tjera, të inkuadruar në formacionet e koalicionit antifashist ose kanë vdekur nga plagët apo sëmundjet e ndryshme të marra në këto luftëra deri në 9 maj 1945;

g) shtetasit e huaj, pjesëtarë të formacioneve të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, që kanë rënë duke luftuar kundër pushtuesve nazifashistë;

gj) shtetasit e huaj, pjesëtarë të formacioneve të ushtrive aleate në Luftën e Dytë Botërore, në ndihmë të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare, të cilët kanë humbur jetën brenda territorit të Shqipërisë;

h) shtetasit shqiptarë, të cilët kanë rënë duke luftuar për pavarësinë e Kosovës, si dhe shtetasit shqiptarë të rënë për të drejtat kombëtare në konfliktet e tjera etnike të zhvilluara në Ballkan;

i) shtetasit shqiptarë që bien në mbrojtje të integritetit territorial të Republikës së Shqipërisë, mbrojtjen e institucioneve shtetërore nga terrorizmi ose në luftën kundër bandave të armatosura dhe krimit ndaj jetës së individit;

j) shtetasit shqiptarë, të cilët vriten nga elementë kriminalë për shkak të detyrës shtetërore që kanë kryer, në luftë kundër krimit dhe përpjekjeve për vendosjen e rendit dhe të qetësisë publike;

k) shtetasit shqiptarë që bien në krye të detyrës, për mbrojtjen e paqes dhe të lirisë së kombit shqiptar, ose ata që bien në krye të detyrës me mision në mbrojtje të paqes e të sigurisë së popujve të tjerë;

l) shtetasit shqiptarë që humbin jetën në krye të detyrës, për mbrojtjen e pasurisë publike ose nga rreziqet e fatkeqësisë natyrore;

ll) shtetasit shqiptarë të vrarë gjatë tubimeve paqësore dhe pa armë për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe ata që kanë humbur jetën në krye të detyrës në mbrojtje të procesit zgjedhor, pas datës 8 dhjetor 1990;

m) shtetasit shqiptarë, të cilët kanë humbur jetën ose që e humbin jetën në përpjekje për të ndihmuar popullsinë në raste fatkeqësish natyrore, në përpjekje për mbrojtjen e pronës publike ose për shpëtimin dhe mbrojtjen e jetës së individit nga krimi;

n) shtetasit shqiptarë që vriten nga forcat apo elementët antishqiptarë në mbrojtje të flamurit, simboleve kombëtare dhe manifestimit të ndjenjave kombëtare;

nj) shtetasit e huaj, pjesëtarë të formacioneve në ndihmë të Forcave të Armatosura të Shqipërisë apo Policisë së Shtetit Shqiptar, të cilët humbin jetën në krye të detyrës, në ndihmë të popullsisë apo në përpjekje kundër terrorizmit ose krimit ndaj jetës së individit;

o) shtetasit e huaj, pjesëtarë të formacioneve ushtarake të NATO-s, në ndihmë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që humbin jetën në krye të detyrës, në mbrojtje të integritetit territorial të Republikës së Shqipërisë;

p) ekuipazhet, të cilët bien në krye të detyrës shtetërore gjatë fluturimit.

q) shtetasit shqiptarë pjesëmarrës në formacionet e Ushtrisë Nacionalçlirimtare që janë ekzekutuar me vendim të gjyqeve partizane për shkelje të moralit partizan dhe që më vonë ka rezultuar që gjykimi ka qenë i pambështetur në prova.

Neni 6

Përjashtimi nga statusi “Dëshmor i atdheut”

Statusin “Dëshmor i atdheut” nuk e përfitojnë personat, të cilët janë dënuar me vendime gjyqate të formës së prerë për:

1. Krime kundër njerëzimit.
2. Bashkëpunim me pushtuesit e vendit.
3. Veprimtari terroriste dhe agjenturore kundër interesave të Shqipërisë.
4. Vrasje me dashje, pas datës 9 maj 1945.
5. Si dhe personat, për të cilët vërtetohet gjyqësisht se vendimi për njohjen e statusit është bazuar në dokumente të falsifikuara.



Neni 7

Dëshmorët e shpallur me vendime të organeve shtetërore të mëparshme

Të gjitha dekretet/vendimet e organeve shtetërore për shpalljen “Dëshmor”, të marra para hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk janë objekt rishikimi nga ky ligj.

Neni 8

Dokumentet për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut”

1. Për shpalljen “Dëshmor i atdheut” vlejnë si burime parësore dokumente të organeve publike, të krijuara në kohën e ngjarjes dhe, si burime dytësore, botimet me karakter historik, folklorik, publicistik e manuale biografike, të cilat shprehen për ngjarjen.

2. Për njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut” vlejnë dekretet/vendimet e organeve shtetërore të mëparshme për shpalljen “Dëshmor”, si dhe, në mungesë të tyre, vetëm burimet parësore, sipas pikës 1, të këtij neni.

Neni 9

Kërkesa për shpalljen “Dëshmor i atdheut” dhe njohjen e statusit

1. Kërkesa për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut” mund të paraqitet nga përfaqësues të familjes së të rënit, për të cilin kërkohet që të shpallet ose të njihet “Dëshmor i atdheut”, ose përfaqësues të autorizuar të organeve shtetërore, organizatave të dëshmorëve të atdheut, shoqërisë civile ose çdo deputet.

2. Format i kërkesës, llojet e dokumenteve, që paraqiten për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut”, si dhe kushtet teknike të plotësimit të tyre përcaktohen me udhëzim të Kryetarit të Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i atdheut”.

KREU III

ORGANET E PARAQITJES SË KËRKESËS, TË PROPOZIMIT DHE MARRJES SË VENDIMIT

Neni 10

Komisioni Qendror i Statusit “Dëshmori i atdheut”

1. Pranë Ministrisë së Mbrojtjes krijohet Komisioni Qendror i Statusit “Dëshmori i atdheut”.

Faqe | 15288

atdheut”, i cili është autoriteti që shpall ose njeh statusin “Dëshmor i atdheut”, sipas propozimit të bërë nga këshilli i qarkut, këshilli bashkiak, prefekti ose ministri përkatës, për subjektet nën fushën e tyre të përgjegjësisë së tij.

2. Komisioni Qendror i Statusit “Dëshmor i atdheut” është organ kolegjal dhe i përhershëm, i cili përbëhet nga 7 anëtarë. Komisioni kryesohet nga ministri i Mbrojtjes dhe në përbërje ka 4 anëtarë në rang zëvendësministrash dhe 2 anëtarë nga organizatat e mbrojtjes së dëshmorëve.

3. Përbërja dhe rregullat e detajuara për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Qendror përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes.

4. Komisioni Qendror i Statusit “Dëshmor i atdheut”, për ushtrimin e përgjegjësisë të caktuara në ligj, mbështetet nga një staf teknik. Përgjegjësi i stafit teknik kryen dhe detyrën e sekretarit teknik të Komisionit Qendror.

5. Anëtarët e Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i atdheut” marrin shpërblym financiar për pjesëmarrjen në mbledhjet e Komisionit Qendror sipas legjislacionit në fuqi. Këshilli i Ministrave cakton masën e shpërblymit si dhe institucionin që kryen pagesën.

6. Propozimet e dërguara nga këshillat e qarqeve, këshillat bashkiakë apo prefektët shqyrtohen nga Komisioni Qendror, brenda 3 muajve, nga afati i regjistrimit në sekretarinë e Komisionit Qendror.

7. Komisioni Qendror raporton para Këshillit të Ministrave, të paktën 1 herë në vit, për punën e bërë për statusin e “Dëshmorit të atdheut”, si dhe në Komisionin për Sigurinë Kombëtare.

Neni 11

Komisionet vendore

1. Pranë këshillave të qarqeve, bashkive dhe pranë prefekturave ngrihen dhe funksionojnë komisione për shqyrtimin e kërkesave për shpalljen ose njohjen e statusit të “Dëshmorit të atdheut”.

2. Kërkesa për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut”, së bashku me dokumentet shoqëruese, i paraqiten komisionit për shqyrtimin e kërkesave pranë këshillit të qarkut, këshillit bashkiak ose prefektit, ku ka vendbanimin familja e të ndjerit që kërkohet të shpallet ose të njihet si “Dëshmor i atdheut”.



3. Komisionet, brenda 1 muaji nga depozitimi i kërkesës, shqyrtojnë kërkesat dhe dokumentet shoqëruese, të cilat relatohen, përkatësisht, në këshillin e qarkut, këshillin bashkiak ose te prefekti, për të vendosur lidhur me kërkesën e bërë.

4. Këshilli i qarkut, këshilli bashkiak ose prefekti merr vendim brenda 1 muaji nga relatimi nga komisioni përkatës, për dërgimin ose jo të propozimit për trajtim pranë Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i atdheut”.

5. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të komisioneve për shqyrtimin e kërkesave për dhënien ose njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut” miratohen sipas përkatësisë, me vendim të këshillit të qarkut, këshillit bashkiak ose prefektit.

Neni 12

Ministri

Në rastet e të rënëve, sipas shkronjave “g”, “h”, “i” e “j”; “l”; dhe “n”, “o”, e “p”, të nenit 5, të këtij ligji, ministri, me fushën e përgjegjësisë së të cilit lidhet aktiviteti shoqëror i të rënit, mund t'i propozojë drejtpërsëdrejti Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i atdheut” shpalljen e të ndjerit “Dëshmor i atdheut”.

KREUIV

VARREZAT E DËSHMORËVE DHE CEREMONITË NË NDERIM TË TYRE

Neni 13

Vendprehja e dëshmorëve të atdheut

1. Në shenjë nderimi, përkujtimi dhe mirënjohjeje kombëtare për dëshmorët e atdheut janë ndërtuar dhe do të ndërtohen varrezat ku prehen dëshmorët e atdheut.

2. Ndërtimi, mirëmbajtja dhe ruajtja e varrezave të dëshmorëve të atdheut bëhet nga shteti, sipas rregullave e procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Çdo dëshmor ka një varr në varrezat e dëshmorëve të atdheut, të ngritur në territorin e qarkut ku ka rënë ose ka pasur vendbanimin, me përjashtim të atyre që prehen në varrezën e dëshmorëve të atdheut “Nëna Shqipëri”, në kryeqytet.

4. Varrimi i dëshmorit të atdheut apo rivarrimi i mbetjeve mortore të tij në varrezën e dëshmorëve

të atdheut “Nëna Shqipëri”, në kryeqytet, bëhet me vendim të Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i atdheut”, me kërkesë të këshillit bashkiak, këshillit të qarkut, prefektit ose ministrit.

5. Varrimi i dëshmorit të atdheut apo rivarrimi i mbetjeve mortore të tij në varrezat e dëshmorëve të atdheut në qarqet përkatëse bëhet me vendim të këshillit të qarkut, këshillit bashkiak ose të prefektit.

6. Për dëshmorët e atdheut, të cilëve nuk u janë gjetur eshtrat, në brendësi të territorit të varrezave të dëshmorëve të atdheut mund të vendosen ndërtime monumentale apo pllaka përkujtimore me emrat dhe të dhënat e tyre.

7. Në varrezat e dëshmorëve të atdheut, në shenjë nderimi, qëndron gjithmonë i ngritur flamuri kombëtar.

8. Varrezat e dëshmorëve të atdheut mbajnë statusin e varrezave monumentale dhe trajtohen si monument kulture, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për shërbimin publik të varrimit dhe për trashëgiminë kulturore.

9. Në vendvarrimet e dëshmorëve të atdheut zhvillohen ceremoni zyrtare dhe homazhe.

10. Në varrezat e dëshmorëve të atdheut nuk lejohen të varrosen persona të tjerë apo mbetjet e tyre mortore që nuk kanë statusin e “Dëshmorit të atdheut”.

11. Shpenzimet e varrimit të dëshmorëve të atdheut ose të rivarrimit të mbetjeve të tyre mortore të përballohen dhe të parashikohen nga buxheti i shtetit.

Neni 14

Ceremonia e varrimit të dëshmorit të atdheut

Varrimi i dëshmorit të atdheut apo rivarrimi i mbetjeve mortore të tij bëhet me ceremoni zyrtare, me arkivol të mbuluar me flamurin kombëtar.

Neni 15

Objektet në nderim të dëshmorëve të atdheut

1. Në shenjë nderimi për dëshmorët e atdheut, me vendim të këshillit të qarkut/këshillit bashkiak/prefektit ose me urdhër të ministrit, brenda territoreve nën juridiksionin e tyre ngrihen, mirëmbahen dhe ruhen, sipas përgjegjësisë përkatëse lapidare, pllaka përkujtimore, përmendore si dhe emërtohen mjedise e institucione publike.



2. Zhvendosja e përmendoreve, lapidarëve, pllakave përkujtimore, si dhe e objekteve të tjera, që kanë lidhje me dëshmorët e atdheut, bëhet vetëm në raste të veçanta, kur këtë e kërkojnë interesi publik dhe me vendim/urdhër të autoritetit që i ka ngritur ato.

3. Zhvendosja e përmendoreve, lapidarëve, pllakave përkujtimore, si dhe e objekteve të tjera, që kanë lidhje me dëshmorët e atdheut, të ngritura nga organe shtetërore, të cilat nuk ekzistojnë më, bëhet me vendim të këshillit bashkiak, në juridiksionin territorial të të cilit ndodhen këto objekte, ose me urdhër të ministrit, në rastet kur këto objekte ndodhen në pronat e paluajtshme në përgjegjësi administrimi të ministrisë përkatëse.

Neni 16

Dita përkujtimore e dëshmorëve të atdheut

Dita përkujtimore e dëshmorëve të atdheut është 5 maji.

Neni 17

Organizimi i ceremonive përkujtimore

Organet e pushtetit qendror e vendor, shoqëria civile, si dhe organizatat e dëshmorëve të atdheut organizojnë dhe marrin pjesë në ceremonitë përkujtimore për dëshmorët e atdheut me rastin e 5 majit dhe 28 e 29 nëntorit.

KREU V

FAMILJET E DËSHMORËVE DHE SIMBOLET NË NDERIM TË TYRE

Neni 18

Familja e dëshmorit të atdheut

1. Familjet e dëshmorëve të atdheut gëzojnë nderim e përkrahje të veçantë nga shteti. Ato përfitojnë shpërblim financiar mujor, kriteret dhe masa e të cilit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit të Mbrojtjes.

2. Në rrethin e familjarëve, për efekt shpërblimi, bëjnë pjesë bashkëshortja/bashkëshortja, fëmijët nën moshën 18 vjeç ose deri në 25 vjeç, kur kryejnë studimet e larta, prindërit bashkëjetues dhe personat në kujdestari, sipas certifikatës së gjendjes familjare në çastin e vdekjes së dëshmorit të atdheut.

3. Shpërblimi ndërpritet kur asnjëri nga familjarët nuk plotëson kushtet e përcaktuara në Faqe|15290

pikën 2, të këtij neni, dhe kur bashkëshortja/bashkëshorti i dëshmorit të atdheut martohet përsëri.

4. Shpërblimi familjar tërhiqet nga secili familjar, sipas pjesës që i përket, nga kujdestari ligjor për fëmijët nën moshën 18 vjeç ose nga përfaqësuesi i pajisur me prokurë.

5. Në familjen e dëshmorit të atdheut, për efekt nderimi dhe mirënjohjeje, përfshihen bashkëshorti/bashkëshortja, bashkëjetuesi/bashkëjetuesja, fëmijët, prindërit, vëllezërit dhe motrat, prindërit e prindërve, emti, emta, thjeshtri, thjeshtra, mbesat dhe nipërit e dëshmorit.

6. Familjarët e dëshmorëve të atdheut, sipas pikës 2, të këtij neni, pranohen në programet e mbrojtjes sociale.

Neni 19

Simbolet e statusit “Dëshmor i atdheut”

1. Familja e dëshmorit të atdheut pajiset nga Komisioni Qendror i Statusit “Dëshmor i atdheut” me certifikatën e dëshmorit të atdheut dhe simbolin “Familje e dëshmorit të atdheut”, me ceremoni zyrtare, që zhvillohen për këtë rast.

2. Procedura e organizimit të ceremonisë së dorëzimit të certifikatës dhe simboleve të dëshmorit të atdheut, si dhe forma dhe përmbajtja e tyre përcaktohen me vendim të Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i atdheut”.

KREU VI

SHOQATA E FAMILJEVE TË DËSHMORËVE TË ATDHEUT

Neni 20

Organizatat e dëshmorëve të atdheut

Në nderim të dëshmorëve të atdheut dhe të promovimit të veprës së tyre mund të krijohen organizata jofitimprurëse (shoqata, fondacione, qendra), veprimtaria e të cilave zhvillohet në mënyrë të pavarur nga organet shtetërore, që veprojnë e përmbushin detyrimet, sipas dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 8788, datë 7.5.2001, “Për organizatat jofitimprurëse”, të ndryshuar.

Neni 21

Organizimi i familjeve të dëshmorëve

1. Familjet e dëshmorëve të atdheut mund të organizohen në organizatat e tyre.



2. Familja e dëshmorit të atdheut dhe organizata e tyre kanë të drejtë të kërkojnë nga organet e njësive të vetëqeverisjes vendore e qendrore marrjen e masave për mirëmbajtjen e varrezave të dëshmorëve të atdheut, të lapidarëve, busteve, pllakave përkujtimore, si dhe çdo kërkesë tjetër të ligjshme në lidhje me dëshmorët e atdheut.

Neni 22

Marrëdhëniet e organizatave me organet shtetërore

1. Shteti mbështet dhe nxit veprimtaritë e organizatave që kanë si objekt të veprimtarisë së tyre dëshmorët e atdheut.

2. Organet e qeverisjes qendrore dhe vendore bashkëpunojnë me organizatat e familjeve të dëshmorëve të atdheut për organizimin dhe zhvillimin e aktivitete në kuadër të festave kombëtare e vendore, si dhe të aktiviteteve që organizohen në kujtim të veprës së dëshmorëve të atdheut.

KREU VII

EDREJTA E ANKIMIT

Neni 23

Ankimi

1. Kundër vendimit të këshillit bashkiak, këshillit të qarkut apo prefektit, që refuzon të pranojë kërkesën ose kur këto organe nuk marrin në shqyrtim kërkesën brenda afateve të parashikuara nga ky ligj, subjektet e interesuara mund të paraqesin ankim pranë Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i atdheut”, brenda 30 ditëve nga marrja dijeni për refuzimin apo nga data e mbarimit të afatit ligjor për marrjen në shqyrtim të kërkesës.

2. Kundër vendimit të Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i atdheut”, si dhe në rastet kur ky komision nuk shprehet brenda afateve të përcaktuara në pikën 6, të nenit 10, të këtij ligji, subjektet e interesuara mund të paraqesin ankim pranë gjykatës kompetente, në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

KREU VIII

DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 24

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatimin të neneve 10, pikat 3 e 5, 13, pika 2, dhe 18, pika 1, të këtij ligji.

2. Ngarkohen këshillat e qarqeve, këshillat bashkiakë dhe prefektët që, brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrin vendimet përkatëse, në zbatim të pikës 5, të nenit 11, të këtij ligji.

3. Ngarkohet Kryetari i Komisioni Qendror të Statusit “Dëshmor i atdheut” që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë udhëzim në zbatim të pikës 2, të nenit 9, të këtij ligji.

4. Ngarkohet Komisioni Qendror i Statusit “Dëshmor i atdheut” që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë vendim në zbatim të pikës 2, të nenit 19, të këtij ligji.

5. Aktet nënligjore, të miratuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që nuk bien në kundërshtim me të, do të zbatohen deri në nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 25

Shfuqizime

Ligji nr. 8607, datë 27.4.2000, “Statusi i dëshmorit të atdheut”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 26

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 20.12.2018

Shpallur me dekretin nr. 11051, datë 14.1.2019 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta



LIGJ
Nr. 112/2018

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË LIGJIN NR. 108/2014,
“PËR POLICINË E SHTETIT”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 6 bëhet ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Pika 16 ndryshohet si më poshtë:

“16. “Punonjës policie” është personi i emëruar në strukturat e Policisë së Shtetit pas përfundimit të arsimit/kualifikimit përkatës dhe mban gradë policore.”.

2. Pas pikës 31 shtohet pika 32 me këtë përmbajtje:

“32. “Funksione të veçanta” do të konsiderohen ato të cilat nuk ofrohen nga Akademia e Sigurisë.”.

Neni 2

Në nenin 19, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Policia e Shtetit është unike, e centralizuar, e organizuar në nivel qendror dhe vendor. Ajo organizohet mbi bazë shërbimi, e profilizuar në Policinë Kriminale, Policinë për Sigurinë Publike dhe Policinë për Kufirin dhe Migracionin. Kategoritë e profilizuara të Policisë së Shtetit dallojnë midis tyre nga arsimi, kualifikimi, simbolet, detyrat dhe përgjegjësitë që ushtrojnë.”.

Neni 3

Në nenin 37, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Për nevoja të Policisë së Shtetit, pranohen në Akademinë e Sigurisë shtetas që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë dhe plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën

2 të nenit 38. Kandidati që përfundon me sukses kualifikimin përkatës pranohet në Policinë e Shtetit dhe i jepet grada policore “Nënkomisar”.”.

Neni 4

Në nenin 38 bëhen këto ndryshime e shtesa:

1. Në pikën 2, shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

“b) të mos jetë i përjashtuar nga Policia e Shtetit, strukturat e tjera të sigurisë kombëtare, apo të jetë larguar nga shërbimi civil.”.

2. Në pikën 2, pas shkronjës “f” shtohet shkronja “g” me këtë përmbajtje:

“g) të plotësojë standardet dhe kriteret e tjera të veçanta që lidhen me konkurrimin, të përcaktuara nga Akademia e Sigurisë dhe të miratuara nga ministri i Brendshëm.”.

Neni 5

Në nenin 40, pika 4, fjalët “1 për qind” zëvendësohen me fjalët “3 për qind”.

Neni 6

Pas nenit 40 shtohet neni 40/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 40/1

1. Për plotësimin e nevojave të veçanta, mund të pranohen në Policinë e Shtetit ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 2, të nenit 38, të këtij ligji.

2. Për ushtarakët e shërbimit aktiv të Forcave të Armatosura, pranimi realizohet me pëlqimin e ushtarakut dhe mbi bazë marrëveshjeje dypalëshe, ndërmjet ministrit të Mbrojtjes dhe ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe të sigurisë publike, ku përcaktohen kuotat, struktura dhe funksionet e veçanta nga ku do të pranohen.

3. Në çdo rast, pranimi, sipas pikës 1, të këtij neni, bëhet pas nxjerrjes në lirim nga Forcat e Armatosura të ushtarakëve, nga autoritetet kompetente të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

4. Pranimi realizohet mbi baza konkurrimi, procedurat e të cilit përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe të sigurisë publike.



5. Kalimi nga strukturat e Forcave të Armatosura të Policia e Shtetit realizohet duke njohur e ruajtur vjetërsinë e shërbimit.

6. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit të Mbrojtjes dhe të ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe të sigurisë publike, miraton ekuivalentimin e gradave të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë me gradat e Policisë së Shtetit.”

Neni 7

Në nenin 54, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Fitimi i gradës “Nënkomisar” deri në “Drejtues i parë” bëhet nëpërmjet pjesëmarrjes në një proces aplikimi, verifikimi, vlerësimi konkurrues dhe përfundimit me sukses të programit përkatës të arsimit/trajnimit.”

Neni 8

Në nenin 55, pika 1, shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

“b) të përmbushë kriteret për pozicionin e punës dhe të ketë përfunduar arsimin e lartë.”

Neni 9

Në nenin 57 bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

1. Në pikën 2, fjalët “intervista me gojë” zëvendësohen me fjalët “në intervistë”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Kufiri minimal për kalimin me sukses të testimit përkatës nuk mund të jetë më i ulët se 70 për qind e vlerës së përgjithshme të pikëve të testimit.”

3. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Përbërja e komisioneve të gradimit dhe ankimit, rregullat dhe procedurat e zhvillimit dhe vlerësimit të kandidatëve në fazat e testimit përcaktohen me rregullore të veçantë të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.”

Neni 10

Në nenin 58 bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i nenit ndryshohet si më poshtë:

“Shpallja e fituesve për procesin e gradimit”

2. Fjalët “fitimin e gradës përkatëse” hiqen.

Neni 11

Në nenin 59 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Pas përfundimit të programit të arsimit/trajnimit, renditja e konkurrentëve bëhet sipas shumës së pikëve të arritura gjatë testimit dhe arsimit/kualifikimit për gradën përkatëse, duke filluar nga punonjësi i cili ka vlerësimin më të lartë.”

2. Pika 4 shfuqizohet.

Neni 12

Pas nenit 59 shtohet neni 59/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 59/1

Dhënia e gradës

Në përfundim të procesit të testimit dhe të arsimit/kualifikimit, dhënia e gradës bëhet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, bazuar në aktin e vlerësimit të komisionit të gradës. Në urdhër përcaktohet edhe funksioni që do të kryejë punonjësi.”

Neni 13

Në nenin 96, pika 2, bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) 6 muaj nga njoftimi i masës “vërejtje” dhe “vërejtje me paralajmërim.”

2. Shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

“b) një vit nga mbarimi i afatit për të cilin është zbatuar masa disiplinore “shtyrje e afatit të gradimit deri në 2 vjet”

Neni 14

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë vendim në zbatim të nenit 7 të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri Brendshëm që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë udhëzimin në zbatim të nenit 7 të këtij ligji.

Neni 15

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 20.12.2018

Shpallur me dekretin nr.11052, datë 14.1.2019 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta



LIGJ
Nr. 113/2018

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
PËR BASHKËPUNIMIN NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
EUROJUST-it

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja për bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust-it, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 20.12.2018

Shpallur me dekretin nr. 11053, datë 14.1.2019
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Ilir Meta

MARRËVESHJE
PËR BASHKËPUNIMIN NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
EUROJUST-it

Republika e Shqipërisë dhe Eurojust-i (në vijim të referuara si “Palët”),

Duke pasur parasysh vendimin e Këshillit të datës 28 shkurt 2002 që themelon Eurojust-in, me synim fuqizimin e luftës kundër krimeve të rënda, të ndryshuar së fundi nga vendimi i Këshillit 2009/426/JHA të datës 16 dhjetor 2008 për forcimin e Eurojust (në vijim i referuar si “vendimi i Eurojust-it”) dhe veçanërisht nenin 26a të tij;

Duke pasur parasysh mendimin e Organit të Përbashkët Mbikëqyrës të krijuar sipas nenit 23 të vendimit të Eurojust-it, datë 17 korrik 2017;

Duke pasur parasysh interesat e Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust-it në zhvillimin e një bashkëpunimi të ngushtë dhe dinamik për të përballuar sfidat e tashme dhe të ardhshme që paraqiten nga krimet e rënda, veçanërisht krimi i organizuar dhe terrorizmi;

Duke pasur parasysh dëshirën për përmirësimin e bashkëpunimit gjyqësor ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust-it, për të lehtësuar bashkërendimin e hetimeve dhe ndjekjeve penale që mbulojnë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe një ose më shumë shtete anëtare të Bashkimit Evropian;

Duke pasur parasysh se Republika e Shqipërisë ka ratifikuar Konventën e Këshillit të Evropës nr. 108, të 28 janarit 1981, për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale dhe Protokollin e saj shtesë, ku të dyja dokumentet luajnë rol themelor në sistemin e Eurojust-it për mbrojtjen e të dhënave;

Duke pasur parasysh nivelin e lartë të mbrojtjes së të dhënave personale në Bashkimin Evropian, veçanërisht, përpunimin e të dhënave personale në përputhje referuar me vendimin e Eurojust-it, Rregullat Procedurale të Eurojust-it për Mbrojtjen e të Dhënave dhe rregulla të tjera të zbatueshme; dhe

Duke respektuar të drejtat dhe parimet themelore të përcaktuara në Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore të 4 nëntorit 1950, të cilat janë reflektuar në Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian;

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

a) “Shtete Anëtare” nënkupton Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian;

b) “Kolegë nënkupton Kolegjin e Eurojust-it, të përmendur në nenin 10 të Vendimit të Eurojust-it;

c) “Anëtar kombëtar” nënkupton anëtarin kombëtar të komanduar tek Eurojust-i nga çdo Shtet Anëtar i Bashkimit Evropian, të përmendur në nenin 2(1) të vendimit të Eurojust-it;

d) “Zëvendës” nënkupton një person, i cili mund të veprojë në emër të ose Zëvendës Anëtar



Kombëtar, i përmendur në nenin 2 (2) dhe nenin 2 (5) të vendimit të Eurojust-it;

e) “Asistent” nënkupton një person, i cili mund të asistojë një anëtar kombëtar ose Prokurorin Ndërlidhës, të përmendur përkatësisht në nenin 2(2) të vendimit të Eurojust-it dhe nenin 5 të kësaj Marrëveshjeje;

f) “Prokuror Ndërlidhës i Eurojust-it” [në vijim i referuar si “Prokuror Ndërlidhës nënkupton një prokuror publik në bazë të të drejtës kombëtare të Republikës së Shqipërisë në lidhje me statusin e tij ose të saj;

g) “Magjistrat Ndërlidhës i Republikës së Shqipërisë” nënkupton një magjistrat të rekrutuar nga Kolegji i Eurojust-it në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me nenin 27a (1) të vendimit të Eurojust-it;

h) “Korrespondent Kombëtar për Çështje të Terrorizmit” nënkupton një prej pikave të kontaktit të caktuara nga autoritetet e Republikës së Shqipërisë në përputhje me nenin 7 të kësaj Marrëveshjeje, përgjegjës për trajtimin e korrespondencës në lidhje me çështje të terrorizmit;

i) “Autoritete gjyqësore”, për Republikën e Shqipërisë, nënkupton gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm dhe prokurorët publikë të të gjitha niveleve;

j) “Drejtor Administrativ” nënkupton Drejtorin Administrativ të referuar në nenin 29 të vendimit të Eurojust-it;

k) “Nepunës i Eurojust-it për Mbrojtjen e të Dhënave” nënkupton një anëtar të emëruar posaçërisht të personelit të Eurojust-it, detyrat e të cilit përcaktohen në nenin 17 të vendimit të Eurojust-it, duke përfshirë, në veçanti, garantimin e ligjshmërisë dhe pajtueshmërisë përpunimit të të dhënave personale nga Eurojust-i në mënyrë të pavarur;

l) “Personel i Eurojust-it” nënkupton personelin e referuar në nenin 30 të vendimit të Eurojust-it;

m) “Rregulla procedurale të Eurojust-it për mbrojtjen e të dhënave” nënkupton rregullat procedurale për përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale pranë Eurojust-it, të miratuara nga Këshilli i Bashkimit Evropian, më 24 shkurt 2005;

n) “Të dhëna personale” nënkupton informacionet në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm (në vijim i

referuar si “subjekti i të dhënave”). Një person i identifikueshëm është ai që mund të identifikohet, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, veçanërisht duke iu referuar një numri identifikimi ose një ose më shumë faktorëve specifikë në lidhje me identitetin e tij ose të saj fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor ose social; dhe

o) “Përpunim i të dhënave personale” nënkupton çdo operacion ose paketë operacionesh që kryhen mbi të dhënat personale, qoftë me mjete automatike ose jo, të tilla si mbledhja, regjistrimi, organizimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, tërheqja, konsultimi, përdorimi, deklarimi nëpërmjet transmetimit, shpërndarja apo vënia në dispozicion në një mënyrë tjetër, harmonizimi apo kombinimi, bllokimi, fshirja ose shkatërrimi.

Neni 2

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është zgjerimi i bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust-it në luftën kundër krimeve të renda, veçanërisht kundër kriminit të organizuar dhe terrorizmit.

Neni 3

Objekti i bashkëpunimit

1. Republika e Shqipërisë dhe Eurojust-i do të bashkëpunojnë në fushat e aktivitetit të përcaktuara në nenet 6, 7 dhe 27b të vendimit të Eurojust-it dhe duke pasur parasysh kompetencat e dhëna anëtarëve kombëtarë në përputhje me nenet 9a–9f të vendimit të Eurojust-it, brenda kompetencave të Eurojust-it të përcaktuara në nenin 4 të vendimit të Eurojust-it.

2. Nëse mandati i Eurojust-it është ndryshuar për mbulimin e fushave të aktivitetit dhe/ose kompetencave, përveç atyre të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, nga data kur ndryshimi i mandatit të Eurojust-it hyn në fuqi, Eurojust-i mund t'i paraqesë Republikës së Shqipërisë me shkrim një propozim për zgjerimin e objektit të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, për të përfshirë mandatin e ri. Kjo Marrëveshje do të zbatohet në lidhje me mandatin e ri që nga data kur Eurojust-i merr pranim me shkrim për propozimin nga Republika e Shqipërisë në përputhje me procedurat e tij të brendshme.



Neni 4

Kompetenca për ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje

1. Autoriteti kompetent i Republikës së Shqipërisë për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje është Prokuroria e Përgjithshme e Republikës së Shqipërisë.

2. Brenda kuadrit të Eurojust-it dhe në përputhje me nenet 6 dhe 7 të vendimit të Eurojust-it, Anëtarët Kombëtarë përkatës dhe Kolegji janë kompetente për ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5

Prokurori Ndërlidhës pranë Eurojust

1. Për të lehtësuar bashkëpunimin e përcaktuar në këtë Marrëveshje dhe në pajtim me dispozitat e nenit 26a(2) të vendimit të Eurojust-it, Republika e Shqipërisë mund të emërojë një prokuror ndërlidhës tek Eurojust-i.

2. Mandati dhe kohëzgjatja e emërimit përcaktohen nga Republika e Shqipërisë.

3. Prokurori ndërlidhës mund të asistohet nga një person. Nëse është e nevojshme, asistenti mund ta zëvendësojë atë.

4. Republika e Shqipërisë njofton Eurojust-in për natyrën dhe shtrirjen e kompetencave gjyqësore të prokurorit ndërlidhës brenda territorit të vet, me qëllim që të kryejë detyrat e tij ose të saj në pajtim me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje. Republika e Shqipërisë përcakton kompetencën e prokurorit ndërlidhës për të vepruar në lidhje me autoritetet gjyqësore të huaja.

5. Prokurori Ndërlidhës ka akses në informacionin që gjendet në regjistrat penalë kombëtare ose në çdo regjistrë tjetër të Republikës së Shqipërisë në të njëjtën mënyrë siç përcaktohet me ligjin e Republikës së Shqipërisë në rastin e një prokurori ose personi me kompetencë të njëjtë.

6. Prokurori Ndërlidhës mund të kontaktojë drejtpërdrejt me autoritetet kompetente të Republikës së Shqipërisë.

7. Eurojust-i duhet të përpiqet të ofrojë ambiente të mjaftueshme për Prokurorin Ndërlidhës, duke përfshirë përdorimin e ambienteve të zyrave dhe shërbimeve të telekomunikacionit, në masën që është e mundur brenda kufizimeve të infrastrukturës dhe buxhetit të Eurojust-it. Eurojust-i mund të kërkojë

rimbursim të çdo shpenzimi që bëhet nga Eurojust-i për ofrimin e këtyre ambienteve. Megjithatë, asnjë rimbursim nuk do të kërkohet në rast se Eurojust-i rekruton një Magjistrat Ndërlidhës dhe të njëjtat ambiente i ofrohen atij ose asaj. Të gjitha detajet për ofrimin e ambienteve dhe rimbursimin e shpenzimeve do të rregullohen me marrëveshje ndërmjet autoritetit kompetent të Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust-it para dërgimit të Prokurorit Ndërlidhës pranë Eurojust-it.

8. Dokumentet e punës së Prokurorit Ndërlidhës mbeten të pacenuara nga Eurojust-i.

Neni 6

Magjistrati Ndërlidhës për Eurojust-in

Me qëllim lehtësimin e bashkëpunimit gjyqësor me Republikën e Shqipërisë në rastet në të cilat Eurojust-i ofron asistencë dhe në përputhje me dispozitat e nenit 27a (1) të vendimit të Eurojust-it, palët mund të vendosin për emërimin e një Magjistrati Ndërlidhës të Eurojust-it në Republikën e Shqipërisë. Megjithatë, Eurojust-i mund të hyjë në bisedime vetëm për emërimin e një Magjistrati Ndërlidhës të Eurojust-it në Republikën e Shqipërisë pasi të ketë marrë miratimin e Këshillit të Bashkimit Evropian për një emërim të tillë.

Neni 7

Pika e kontaktit tek Eurojust

1. Republika e Shqipërisë do të caktojë ose emërojë të paktën një pikë kontakti pranë Eurojust-it, në zyrën e autoritetit kompetent të Republikës së Shqipërisë. Ky emërim i njoftohet Eurojust-it sipas rregullave, me shkresë zyrtare.

2. Republika e Shqipërisë cakton një nga pikat e tij të kontaktit si Korrespondent Kombëtar i Republikës së Shqipërisë për Çështje të Terrorizmit.

Neni 8

Mbledhjet operacionale dhe strategjike

1. Prokurori ndërlidhës, asistenti i tij ose i saj dhe përfaqësues të autoriteteve të tjera kompetente të Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë pikën e kontaktit për Eurojust-in, mund të marrin pjesë në mbledhjet operacionale dhe strategjike, me ftese të Presidentit të Eurojust-it dhe me miratimin e anëtarëve kombëtarë përkatës.



2. Anëtarët kombëtare, zëvendësit dhe asistentët e tyre, Drejtori Administrativ dhe personeli i Eurojust-it mund të marrin pjesë gjithashtu në mbledhjet e organizuara nga prokurori ndërlidhës ose autoritetet e tjera kompetente të Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë pikën e kontaktit të Eurojust-it.

Neni 9

Shkëmbimi i informacionit

1. Në përputhje me këtë Marrëveshje, Palët mund të shkëmbejnë të gjithë informacionin që është i nevojshëm, i rëndësishëm dhe jo i tepërt për arritjen e qëllimit të kësaj Marrëveshjeje, siç përcaktohet në nenin 2 të saj.

2. Pala kërkuese njofton Palën tjetër për qëllimin për të cilin kërkohet informacioni. Në rastin e transferimit të paparashikuar të informacionit, Pala që ofron informacionin njofton Palën tjetër për qëllimin për të cilin është dhënë informacioni.

3. Pala që ofron informacionin mund të vendosë kufizime për përdorimin e informacionit të dhënë, i cili duhet të respektohet nga Pala tjetër. Kjo përfshin edhe kufizime të mundshme të aksesit, kufizime për transmetimin e mëtejshëm dhe kushte për fshirje ose shkatërrim. Njoftimi mund të jepet edhe në një fazë të mëvonshme, kur nevoja për kufizime të tilla evidentohet pas transferimit.

4. Palët mbajnë të dhëna të transmetimit dhe marrjes së të dhënave të komunikuara sipas kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë konfirmimet për këto transmetime. Për këtë qëllim, Republika e Shqipërisë mund të hartojë një regjistër në përputhje me të drejtën e vet kombëtare.

Neni 10

Kanalet e transmetimit

1. Informacioni do të shkëmbehet:

a) ose ndërmjet Prokurorit Ndërlidhës ose, nëse nuk është emëruar ose ndryshe nuk është në dispozicion asnjë Prokuror Ndërlidhës, ndërmjet pikës së kontaktit tek Eurojust-i dhe anëtarëve kombëtarë përkatës ose Kolegjit; ose

b) nëse Eurojust-i ka rekrutuar një Magjistrat Ndërlidhës pranë Republikës së Shqipërisë ndërmjet Magjistratit Ndërlidhës tek Eurojust-i dhe ndonjë autoriteti kompetent të Republikës së Shqipërisë; ose

c) drejtpërdrejt ndërmjet autoritetit gjyqësor të ngarkuar për hetimin dhe/ose ndjekjen penale dhe/ose kryerjen e procedimeve penale dhe anëtarëve kombëtarë përkatës ose Kolegjit. Në këtë rast, Prokurori Ndërlidhës ose, nëse është e zbatueshme, Magjistrati Ndërlidhës pranë Eurojust-it informohen për shkëmbime të tilla informacioni.

2. Palët nuk përjashtohen nga dakordësia për të përdorur mjete të tjera për shkëmbimin e informacionit në raste të veçanta.

3. Të dyja palët garantojnë që përfaqësuesit e tyre përkatës janë të autorizuar të shkëmbejnë informacion në nivelin e duhur dhe të verifikohen në mënyrë të mjaftueshme.

Neni 11

Privatësia dhe mbrojtja e të dhënave

1. Palët pranojnë se trajtimi dhe përpunimi i duhur dhe i mjaftueshëm i të dhënave personale që marrin nga njëra tjetra, janë të një rëndësie vendimtare për ruajtjen e besimit në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

2. Palët garantojnë një nivel mbrojtjeje për të dhënat personale të ofruara nga pala tjetër, të paktën të barasvlershëm me atë që rrjedh nga zbatimi i parimeve në përmbajtje të Konventës së Këshillit të Evropës të 28 janarit 1981 për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale dhe ndryshimet pasuese të tyre, si dhe në parimet e përcaktuara në vendimin e Eurojust-it dhe rregullat procedurale të Eurojust-it për mbrojtjen e të dhënave.

3. Në lidhje me të dhënat personale të shkëmbyera sipas kësaj Marrëveshjeje, Palët garantojnë që:

a) të dhënat personale janë përpunuar në mënyrë të drejtë;

b) të dhënat personale të ofruara janë të mjaftueshme, të rëndësishme dhe jo të tepërta në lidhje me qëllimin specifik të kërkesës ose transferimin e përcaktuar në nenin 9 (2) të kësaj Marrëveshjeje;

c) të dhënat personale mbahen për aq kohë sa është e nevojshme për qëllimin për të cilin janë dhënë ose përpunuar më tej në përputhje me këtë Marrëveshje; dhe



d) të dhëna personale, që mund të jenë të pasakta, sillen në kohë në vëmendjen e palës marrëse, me qëllim marrjen e masave të duhura korrigjuese.

Neni 12

Transmetimi i kategorive të veçanta të të dhënave personale

1. Të dhënat personale që zbulojnë origjinën etnike ose raciale, mendimet politike ose besime fetare ose besime të tjera, anëtarësimin në sindikata ose në lidhje me shëndetin dhe jetën seksuale, mund të jepen vetëm nëse janë rreptësisht të nevojshme për një qëllim të përcaktuar në nenin 2, të kësaj Marrëveshjeje.

2. Palët marrin masa mbrojtëse të nevojshme, veçanërisht masa të duhura teknike dhe të sigurisë organizative, për të vepruar në përputhje me sensitivitetin e veçantë të kategorive të të dhënave personale të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 13

E drejta e informacionit dhe aksesit në të dhënat personale

1. Subjekti i të dhënave ka të drejtën për t'u informuar për përpunimin e të dhënave të tij ose të saj personale, në përputhje me dispozitat e zbatueshme të përcaktuara, në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë dhe kuadrin ligjor të Eurojust-it.

2. Subjekti i të dhënave ka të drejtën e aksesit në të dhënat e tij ose të saj personale të shkëmbyera sipas kësaj Marrëveshjeje. Aksesit ushtrohet në përputhje me ligjin e zbatueshëm për Palën së cilës i paraqitet kërkesa. Kjo palë garanton që vendimi i saj i komunikohet subjektit të të dhënave në kohën e duhur. Aksesit në të dhënat personale mohohet, nëse dhënia e këtij aksesit mund të rrezikojë:

a) qëllimet e përpunimit;

b) hetimet, ndjekjet penale dhe procedimet penale të kryera nga autoritetet kompetente në Republikën e Shqipërisë ose nga autoritetet kompetente në shtetet anëtare që asistohen nga Eurojust-i; ose

c) të drejtat dhe liritë e palëve të treta.

3. Pala së cilës i paraqitet kërkesa, i jep palës tjetër mundësinë për të shprehur mendimin e saj në lidhje me ekzistencën e mundshme të një prej arsyeve për mohimin e aksesit, të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni.

Faqe | 15298

4. Ky nen nuk cenon të drejtat që një individ mund të ketë sipas ligjit të zbatueshëm për Palën transmetuese, për të kërkuar nxjerrjen e informacionit nga ajo Palë ose ndonjë ndihmë tjetër të përshtatshme.

Neni 14

E drejta e korrigjimit, bllokimit dhe fshirjes së të dhënave personale

1. Subjekti i të dhënave është i autorizuar t'i kërkojë Palës që ka përpunuar të dhënat në lidhje me të sipas kësaj Marrëveshjeje, të korrigjojë, bllokojë ose fshijë ato të dhëna që janë të pasakta ose të paplota, ose nëse mbledhja, përpunimi ose ruajtja e tyre e mëtejshme është në kundërshtim me këtë Marrëveshje ose rregullat përkatëse të zbatueshme për Palët. Kjo kërkesë duhet të bëhet me shkrim dhe të përfshijë të gjithë informacionin përkatës për vërtetimin e saj.

2. Nëse një Palë vihet në dijeni qoftë nëpërmjet kërkesës së subjektit të të dhënave, nëpërmjet njoftimit nga Pala transmetuese ose me ndonjë mënyrë tjetër, se informacioni që ka marrë nga Pala tjetër nuk është i saktë, ajo do të marrë të gjitha masat e duhura për mbrojtje ndaj bazimit të gabuar në këtë informacion, i cili mund të përfshijë plotësimin, fshirjen ose korrigjimin e një informacioni të tillë.

3. Nëse një Palë vihet në dijeni se informacioni që zotëron shkakton dyshim të konsiderueshëm në lidhje me saktësinë e informacionit të marrë sipas kësaj Marrëveshjeje ose është kryer një vlerësim nga Pala tjetër për saktësinë e informacionit ose besueshmërinë e një burimi, ajo do të informojë për këtë Palën tjetër.

Neni 15

Afatet kohore për ruajtjen e të dhënave personale

Të dhënat personale do të ruhen vetëm për atë kohë sa është e nevojshme për arritjen e qëllimeve të kësaj Marrëveshjeje ose për qëllimet për të cilat të dhënat ishin mbledhur ose përpunuar më tej sipas nenit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 16

Siguria e të dhënave

Palët garantojnë që masat e nevojshme teknike dhe organizative të shfrytëzohen për mbrojtjen e të



dhënave personale, të marra sipas kësaj Marrëveshjeje kundër shkatërrimit të rastësishëm ose të paligjshëm, humbjes së rastësishme ose zbulimit, ndryshimit, aksesit të paautorizuar ose ndonjë forme të paautorizuar përpunimi. Në veçanti, palët garantojnë se vetëm palët e autorizuar për akses në të dhëna personale mund të kenë akses në këto të dhëna.

Neni 17

Transferimet e mëtejshme

Palët nuk i komunikojnë ndonjë informacion të dhënë nga Pala tjetër, një Shteti ose organizmi të tretë, pa pëlqimin e këtij të fundit dhe pa garanci të duhura në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 18

Përgjegjësia

1. Republika e Shqipërisë, në pajtim me të drejtën e saj të brendshme, është përgjegjëse për çdo dëm të shkaktuar një individ si rezultat i gabimeve ligjore ose faktike në të dhënat e shkëmbyera me Eurojust-in. Republika e Shqipërisë nuk pretendon që Eurojust-i kishte transmetuar të dhëna të pasakta, me synim shmangien e përgjegjësisë sipas të drejtës së vet të brendshme kundrejt një pale të dëmtuar.

2. Pa cenuar nenin 24 të vendimit të Eurojust-it, nëse gabimet ligjore ose faktike kanë ndodhur si rezultat i të dhënave të komunikuara gabimisht nga Eurojust-i ose një prej Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian ose një shtet apo organizëm tjetër i tretë, Eurojust-i është i detyruar të shlyejë, me kërkesë, shumat e paguara si kompensim sipas paragrafit 1 të këtij neni, përveç kur të dhënat janë përdorur në shkellje të kësaj Marrëveshjeje. Dispozitat e këtij paragrafi zbatohen edhe në rastet kur gabimet ligjore ose faktike kanë ndodhur si rezultat i mosrespektimit të detyrimeve të veta nga ana e Eurojust-it apo e një prej shteteve anëtare të Bashkimit Evropian apo e një shteti ose organizmi të tretë.

3. Në rastet kur Eurojust-i është i detyruar t'u shlyejë shteteve anëtare të Bashkimit Evropian ose një shteti apo organizmi tjetër të tretë, shumat e dhëna si kompensim për dëmet ndaj një pale të dëmtuar, dhe nëse dëmet kanë ndodhur për shkak të mosrespektimit nga ana e Republikës së Shqipërisë të detyrimeve të saj sipas kësaj Marrëveshjeje, Republika e Shqipërisë do të jetë e

detyruar të shlyejë, sipas kërkesës, shumat që Eurojust-i i ka paguar një shteti anëtar ose një pale apo organizmi tjetër të tretë për plotësimin e shumave që ka paguar në kompensim.

4. Palët nuk i kërkojnë njëra-tjetrës të paguajnë kompensim për dëmet sipas paragrafëve 2 dhe 3 të këtij neni, në masën që kompensimi për dëmet ishte zbatuar si dëme ndëshkimore, të shtuara apo dëme të tjera jokompensuese.

Neni 19

Konsultimet e rregullta

1. Palët kryejnë, të paktën një herë në vit, shkëmbime të rregullta të pikëpamjeve në lidhje me zbatimin dhe zhvillime të mëtejshme në fushën e mbrojtjes së të dhënave dhe sigurisë së të dhënave.

2. Për këtë qëllim, Oficeri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i Eurojust-it dhe Autoriteti për Mbrojtjen e të Dhënave në Republikën e Shqipërisë do t'i raportojnë njëri-tjetrit të paktën një herë në vit mbi gjendjen e zbatimit të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje për mbrojtjen e të dhënave.

3. Kur është e nevojshme, çështjet e identifikuara nga palët në kontekstin e këtyre konsultimeve për mbrojtjen e të dhënave, do t'u raportohen mekanizmave të duhur mbikëqyrës dhe në veçanti, Organizmit të Përbashkët Mbikëqyrës të Eurojust-it.

Neni 20

Monitorimi i zbatimit

1. Për qëllimin e monitorimit të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, Palët kryejnë një rishikim të përbashkët vjetor të zbatimit të saj.

2. Çështjet e mundshme, të identifikuara nga palët në kontekstin e këtyre rishikimeve të përbashkëta, trajtohen bashkërisht nga palët në pajtim me nenin 23 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 21

Mbikëqyrja e zbatimit

Ekzekutimi dhe zbatimi i kësaj Marrëveshjeje nga Palët i nënshtrohen mbikëqyrjes në pajtim me ligjet dhe procedurat e tyre të zbatueshme. Palët përdorin organet e tyre përkatëse administrative, gjyqësore ose mbikëqyrëse për të garantuar një nivel të përshtatshëm pavarësie të procesit të mbikëqyrjes.



Neni 22

Shpenzimet

Pa cenuar menin 5 (7) të kësaj Marrëveshjeje, asnjë Palë nuk paraqet ndonjë pretendim monetar kundër Palës tjetër për shpenzime që lindin nga ekzekutimi i kësaj Marrëveshjeje. Nëse nga ekzekutimi i kësaj Marrëveshjeje lindin shpenzime të një natyre të jashtëzakonshme, Palët mund të konsultohen me synim përcaktimin e mënyrës në të cilën duhet të trajtohen.

Neni 23

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Palët do të takohen menjëherë, sipas kërkesës të secilës prej tyre, për zgjidhjen e ndonjë mosmarrëveshjeje në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje ose ndonjë çështje që cenon marrëdhënien ndërmjet tyre.

2. Nëse një mosmarrëveshje për interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje nuk mund të zgjidhet, Palët mund të hyjnë në bisedime për çështjen specifike.

Neni 24

Ndryshimet

1. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet në çdo kohë, bazuar në pëlqimin e ndërsjellë me shkrim ndërmjet Palëve. Një ndryshim i tillë do të hyjë në fuqi pasi palët të kenë njoftuar njëra-tjetrën për përmbushjen e kërkesave të tyre përkatëse të brendshme.

2. Palët hyjnë në konsultime në lidhje me ndryshimin e kësaj Marrëveshjeje, me kërkesë të njëres prej tyre.

Neni 25

Përfundimi i kësaj Marrëveshjeje

1. Kjo Marrëveshje mund të përfundohet nga secila prej palëve nëpërmjet një njoftimi me afat tremujor.

2. Në rastin e përfundimit të Marrëveshjes, palët bien dakord sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje për përdorimin dhe ruajtjen e vazhdueshme të informacionit që tashme është komunikuar ndërmjet tyre. Nëse nuk arrihet asnjë marrëveshje, secila prej palëve ka të drejtë të kërkojë fshirjen e informacionit që është komunikuar.

Neni 26

Hyrja në fuqi

Sapo Palët të kenë përmbushur kërkesat e tyre ligjore, ato do të njoftojnë njëra-tjetrën me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike për përfundimin e procedurave të brendshme të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën pas njoftimit të fundit.

Hartuar në Tiranë, në datën 5 tetor dy mijë e tetëmbëdhjetë, në dy kopje, në gjuhët shqipe dhe angleze, ku secili tekst është njëllor autentik.

Në rast mospërputhjeje, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Ministri i Drejtësisë

Etilda Gjonaj (Saliu)

PËR EUROJUST-in

Presidenti

Ladislav Hamran

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 168 lekë